



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 477/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) që të dyja me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik (LVV), ne te cilën pretendohet se 150 persona anëtarë të subjektit politik PDK dhe LDK kanë qëndruar para Qendrës së Votimit në fshatin Zhegër komuna e Gjilanit duke i penguar qytetarët për të shfrytëzuar të drejtën e votimit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Në Raportin e Policisë të datës 15.12.2010 lidhur me rastin konkret nuk është paraqitur ndonjë rast në Polici për pengim të personave për të ushtruar të drejtën e votimit siç pretendon parashtruesi i ankesës.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh, se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë shkelja e theksuar janë të pabazuara nga shkakun se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë, këtë e bën edhe më të besuar raporti i Policisë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 477/2010 më datën 16.12.2010.

